



*ORGANIZATA PËR DEMOKRACI, ANTIKORRUPSION
DHE DINJITET – ÇOHU!*

LUFTIMI I KORRUPSIONIT ME RETORIKË

RAPORT:

100 DITË TË QEVERISË THAÇI

RAPORTI #8

PRILL 2008

Rruga "UÇK" 105, Kati III/7 Prishtinë
organizatacohu@yahoo.com
www.cohu.org
038 248 506

Përmbajtja:

HYRJE.....	3
MBI RAPORTIN.....	4
SHKELJET KRYESORE QË PËRCOLLËN QEVERINË NË 100 DITËT E PARA.....	4
TRANSPARENCA E CENTRALIZUAR.....	5
KOMPANITË PUBLIKE: LUFTA PËR INTERESA TË NGUSHTA.....	6
<i>KEK: përplot akuza por pa plan.....</i>	<i>7</i>
<i>PTK: pa zot shtëpie.....</i>	<i>8</i>
<i>ANP: zëvendësimi me struktura lojale.....</i>	<i>9</i>
<i>Privatizimi pa rezultate.....</i>	<i>9</i>
ADMINISTRATA PUBLIKE: TRADITA (E POLITIZIMIT) VAZHDON.....	10
ARSIMI I LARTË: FUSHA E SUPERMENAWE.....	11
<i>Super ministrat-profesorë.....</i>	<i>12</i>
<i>Profesorët shkelin ligjin.....</i>	<i>13</i>
<i>Politizimi i UP-së.....</i>	<i>13</i>
SHËNDETËSIA E PARTIZANËVE.....	14
KONKLUZION.....	16
APPENDIX I.....	17
Infrastruktura Ligjore dhe Institucionale kundër korrupsionit.....	17

Hyrje

Krijimi i Qeverisë Thaçi, gjegjësisht koalicionit PDK-LDK, erdhi në një situatë kur raportimet për korrupsion dhe krim të roganizuar kishin arritur kulmin. Aq i lodhur ishte opinionin kosovar nga raportet për shkelje, korrupsion, dështime të qeverisë, keqpërdorim të pushtetit dhe injorim të problemeve të qytetarëve saqë zgjedhjet u bënë pothuajse sa për ta konfirmuar futjen si kryeministër të dikujt që akoma s'e kishte kompromituar pushteti dhe deri diku nga partitë e mëdha i tillë kishte ngelur Hashim Thaçi. Kështu u krijuan pritjet se qeveria që do ta udhëheqë zoti Thaçi do të shënojë një kthesë drejt një qeverisje më të mirë meqë ishte shumë e vështirë të besohej se mund të bëhet një qeveri aq e keqe sikur ajo paraprijëse e Qeverisë Thaçi.

Ajo që pasoi shumë shpejt pas krijimit të kësaj qeverie në vetvete përmbante një fat dhe shpërblim për zotin Thaçi duke qenë se shpallja dhe njohja e pavarësisë krijoi rrethana tepër të vështira për të vlerësuar e matur vërtet qeverisjen që solli kabineti i tij. Sido që të jetë në fund të këtyre 100 ditëve të qeverisjes mund të thuhet se ka pasur përpjekje dhe veprime drejt një qeverisjeje më të mirë, por, siç do të shihet nga ky raport, vendimet dhe veprimet e qeverisë aktuale shpesh kanë favorizuar shkeljet dhe korrupsionin, luftimi i të cilave dukuri ishte boshti i premtimeve të PDK-së dhe tepër pak kanë përmbushur premtimet.

Qeveria Thaçi premtoi se do të jetë më e hapur ndaj publikut kosovar dhe madje filloi për herë të parë praktikën e mbajtjes së mbledhjeve të qeverisë me dyer të hapura në praninë e medias. Natyrisht ishte ky një hap i mirë i parë për të ndërtuar një përshtypje të një qeverie të hapur që jep llogari para publikut, por vendimet e mëvonshme në aspektin e komunikimit me publikun, jashta këtyre mbledhjeve formale të qeverisë, në momentet kur publiku e media kishin nevojë për informacion, kishin tendencë të mbylljes dhe centralizimit të komunikimit nëpërmjet një zëri të monopolizuar që artikulohej herë nga kryeministri Hashim Thaçi e herë nga zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi. Një test i Organizatës ÇOHU! për zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumenta Zyrtare të bërë në fund të muajit mars dhe në fillim të muajit prill e ka nxjerrë qeverinë aktuale në një dështim gati total në zbatimin e këtij ligji.

Përkundër mungesës së informacioneve të mjaftueshme zyrtare, informatat që Organizata ÇOHU! ka në dispozicion tregojnë një tendencë të rënies së shpenzimeve operative të Qeverisë Thaçi në krahasim me shpenzimet enorme të qeverisë së kaluar. Mirëpo, në përgjithësi, praktika e ndjekur dhe vendimet e marra nga Qeveria Thaçi nuk janë në pajtim me objektivat e premtuara dhe retorikën e tij gjatë zgjedhjeve dhe në fillim të mandatit. Ideja e proklamuar gjerësisht për një qeverisje të mirë dhe mbrojtje të kompanive publike, profesionalizmit dhe depolitizimit të kompanive e administratës publike në praktikë u zëvendësuan me tendenca të politizimit e manipulimit politik të sektorit publik dhe madje edhe krijimit të konfliktit të interesave në dëm të pasurisë publike. Premtimi për tejkalimin e krizës energjetike u reduktua në një veprim njëdimensional të kufizuar në akuza për korrupsion duke e vënë këtë sektor në një ngërç për shkak të bllokadës në komunikim me KEK-un.

Përgjithësisht kjo qeveri ka bërë më shumë fushatë për krijimin e përshtypjes së parë të mirë sesa vendime e veprime për të realizuar atë që është premtuar. Është premtuar luftim i korrupsionit, kurse në të vërtetë jo vetëm që substancialisht nuk është bërë diçka për luftimin e korrupsionit por madje ka pasur raste kur është favorizuar korrupsioni.

Mbi raportin

Ky është një raport mbi 100 ditët e para të Qeverisë Thaçi i përgatitur nga Organizata ÇOHU! për të monitoruar ekzekutivin e ri të Kosovës. Kjo bëhet sidomos pasi që kryeministri Thaçi erdhi në pushtet me një retorikë të ashpër kundër korrupsionit gjë që ngjalli shpresa te qytetarët e Kosovës për një qeverisje më të mirë. Për të argumentuar se retorika jo vetëm që ka mbetur boshe por ajo është përcjellë edhe me tolerim të korrupsionit, ky raport është përqendruar në tri fusha kryesore: kompanitë publike, arsimi dhe shëndetësia. Kompanitë publike janë një ilustrim i kundërthënieve të qarta mes retorikës dhe tolerimit të korrupsionit sepse aty kanë ndodhur shkeljet më të mëdha, tolerimi i korrupsionit dhe politizimi i institucioneve publike. Arsimi dhe shëndetësia, dy sektorë shumë vital për mirëqenien e një populli, poashtu janë një manifestim i kësaj qeverie që mund të gjeneralizohet thjesht në një luftë politike gjatë këtij 100 ditëshi për të zëvendësuar njerëzit e qeverisë së kaluar me njerëzit e kësaj qeverie dhe monopolizimin e institucioneve që për nga natyra janë apolitike.

Në fund, një Appendix i është bashkëngjitur këtij raporti ku elaborohet mbi infrastrukturën ligjore dhe institucionale të nevojshme për luftimin e korrupsionit, ku ceket se vullneti politik i munguar është përgjegjës për mungesën e rezultateve në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Shkeljet kryesore që përrollën qeverinë në 100 ditët e para

Koha e shkurtër dhe fokusimi në zgjidhjen e statusit mund të konsiderohet si pengesë serioze për përmbushjen e premtimeve, por kjo nuk arsyeton assesi vendimet qëllimisht të gabuara dhe të kundërligjshme, të cilat do të konstatohen në këtë raport. Në vazhdim do të përmbledhim në pika të shkurtëra të arriturat si dhe dështimet e shkeljet kryesore të kësaj qeverie në 100 ditëshin e parë.

Të arriturat kryesore:

- Tendencë e reduktimit të shpenzimeve operative të Qeverisë në vetura, karburante dhe telefona
- Vendimi që agjensioni për akreditimin e institucioneve të arsimit të lart të përbëhet tërësisht nga staf ndërkombëtar dhe ngrirja e postit të profesorit nga ministri i arsimit Enver Hoxhaj që të shmanget konflikti i interesit

Shkeljet/dështimet kryesore:

- Konflikti i interesit i shkaktuar me kandidimin e Dino Asanajt në Bordin e AKM-së
- Kandidimi i nënkryetarit të LDK-së dhe kryetarit të KK të Istogut, Fadil Ferati, në Bordin e AKM-së përkundër premtimit për depolitizim.

- Dhënia pa tender e rreth 600 mijë eurosh për kompaninë e marketingut që ka bërë fushatën për PDK-në në zgjedhjet e fundit
- Emërimi ushtrues detyre i drejtorit të Aeroportit të Prishtinës i një kandidati të afërt me PDK-në, rreth të cilit ngrihen dyshime për korrupsion
- Dështimi në adresimin e situatës energjetike dhe kufizimi i qeverisë vetëm në akuza për KEK pa ndonjë veprim a plan konkret
- Mbyllja e Qeverisë ndaj publikut nëpërmjet monopolizimit të burimit të informacionit
- Dështimi i mbrojtjes së kompanive publike për shkak të moskrijimit të bordeve dhe për shkak të favorizimit të konfliktit të interesit në AKM në raport me PTK-në
- Zgjedhja drejtor i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës ish-kryetari i degës së PDK-së për Podujevë
- Zgjedhja shef i Autoritetit Qendror Bankar e një kandidati me afera korruptive përkundër alarmimit të këtyre dyshimeve në Parlament
- Zgjedhja e shefave të zyrave të prokurimit në Ministrinë e Shërbimeve Publike dhe në Ministrinë e Transporteve dhe Telekomunikacionit e dy kandidatëve për të cilët raportet e auditimit ngrejnë dyshime për shkelje serioze
- Dështimi i përmbushjes së premtimit të ministrave të dhënë në mbledhjen e parë të qeverisë se do të fokusohen në punën e tyre dhe do të japin dorëheqje nga punët tjera
- Përkeqësimi i gjendjes në shëndetësi si pasojë e personalizimit të sektorit mes ministrit Gashi dhe sekretarit Tolaj
- Politizimi i mëtutjeshëm i administratës publike

Natyrisht asnjëra nga këto dy lista nuk ezaurojnë të gjitha arritjet ose shkeljet e qeverisë, por janë një përmbledhje e rasteve më të rëndësishme të identifikuara nga Organizata ÇOHU!

Transparenca e centralizuar

Në Qeverinë Thaçi po manifestohet një tendencë për të centralizuar komunikimin me publikun dhe median gjë e cila është në kundërshti me parimet e përgjithshme të transparencës dhe qeverisjes së mirë. Ky centralizim i komunikimit me publikun ngre dyshimet se qeveria ka për qëllim të kontrollojë informatat të cilat dalin nga zyrtarët e saj e të cilat do të duhej të ishin të hapura dhe në dispozicion për të gjithë. Kryeministri Thaçi në vend të emërimit të një zëdhënësi i cili do t'i mbante marrëdhëniet me mediat dhe do t'u përgjigjej kërkesave të tyre për informata zyrtare në çdo kohë, ka caktuar si përgjegjës për media zëvendësin e tij të parë nga partia dhe zëvendësin e tij në ekzekutiv, zëvendës-kryeministrin Hajredin Kuçi.

Ky emërim i zyrtarit Numër 2 si “përgjegjës për media” flet për një tendencë të kryeministrit për t'ia besuar komunikimin me publikun një personi që është lojal dhe besnik ndaj tij, një personi të cilin mund ta “kontrollojë” por edhe që është i lartë në hierarkinë partiake dhe qeveritare dhe, rrjedhimisht, e din se çfarë duhet dhe çfarë nuk duhet të “dijë” publiku. Mediat e kanë zbuluar ndërkohë se përgjegjësi për media ka qenë në dispozicion të tyre vetëm për çështje të cilat kanë qenë afirmative për punën e

qeverisë, që kanë promovuar të “arriturat” dhe planet e qeverisë. Por ai nuk është përgjigjur fare kur gazetarët kanë hulumtuar për korrupsion dhe keqpërdorime nga ana e qeverisë. Arroganca e zotit Kuçi në marrëdhëniet me mediat i ka dekurajuar këto që të interesohen më thellësisht dhe të hulumtojnë më gjerë veprimet e qeverisë.

Një situatë e ngjajshme është edhe në disa nga institucionet tjera. Sipas disa raportimeve në media, ministri i ekonomisë, Ahmet Shala, ua ka ndaluar të gjithë zyrtarëve në ministrinë e tij që të komunikojnë me mediat. Askush tjetër përveç tij nuk ka të drejtë të komunikojë me publikun. Kjo paranojë dhe centralizim i komunikimit me publikun të përkujton një anekdotë prej kohës kur Bajram Kosumi ishte kryeministër i Kosovës, ku pas pushimit nga puna të një zëdhënësi të tij, zyrtarët e kabinetit të Kosumit ishin shprehur se “tash më nuk po dalin skandale nga zyra”. Kjo tendencë për të kontrolluar marrëdhëniet me publikun në mënyrë që të mos “dalin skandale nga zyra” po manifestohet edhe me zëvendësimin e zyrtarëve të Zyrave për Informim Publik me anëtarë të PDK-së apo të afërt me të. Në Zyrën e Kryeministrit në mars u zëvendësuan zyrtarët përgjegjës për marrëdhënie me publikun, me zyrtarë lojal dhe anëtarë të PDK-së. E njëjta ndodhi edhe me zyrtarin për marrëdhënie me publikun në ministrinë e punës që u zëvendësua me një person të afërt me PDK-në.

Kjo situatë e “transparencës” së centralizuar përngjan me situatat orvelliane ku Vllau i Madh i dirigjon mediat drejt informatave që ai zgjedh t’ua komunikojë dhe nëpërmes Ministrisë së Vërtetës prodhon “të vërteta” që ushqejnë iluzionin e qeverisë së popullit. Ky kontrollim i informacionit e ka pasur për objektiv ndërtimin e një imazhi kundërkorrupsion të qeverisë Thaçi. Rasti më i njohur i një shou të tillë ka qenë kur zoti Thaçi filloi të shpallte kampion në korrupsion kompanitë publike. Kurse rasti më i freskët është ai i një manipulimi tipik të opinionit kur ministri i transporteve Fatmir Limaj duke përdorë ndonjë media të kontrolluar arriti të bind një pjesë të opinionit se ka filluar rrënimi i objekteve për ndërtimin e magjstrales Prishtinë-Han i Elezit. Ajo që në praktikë ka ndodhur nuk ka qenë rrënim por një gërvishtje e zakonshme skaj rrugës përballë qendrave të njohura tregtare.

KOMPANITË PUBLIKE: LUFTA PËR INTERESA TË NGUSHTA

Për një kohë të gjatë, pothuajse në të gjitha mandatet e deritashme qeverisëse, kompanitë publike i janë ekspozuar një dëmtimi të vazhdueshëm dhe pengimi të zhvillimit normal për shkak të shumë arsyeve por që një nga këto arsye është e sigurt se ka qenë korrupsioni dhe përdorimi i resurseve të tyre për qëllime politike e interesa të ngushta. Bordet e kompanive publike kanë qenë të përbëra nga ministra të cilëve jo vetëm që iu ka munguar ekspertiza elementare në fushën ku kanë sjellë vendime, por edhe iu ka munguar integriteti ndaj ndikimeve politike e interesave të ngushta private e klanore dhe shpesh kanë vepruar edhe në konflikt formal të interesit.

Kryeministri Thaçi me të marrë detyrën filloi të zotohet se do të adresojë dobësitë e kompanive publike, të cilat në një masë të madhe në mandatin e kaluar vinin pikërisht nga bordet e tyre, të cilat, paradoksisht, ishin atje për t’i mbrojtur dhe zhvilluar ato. Angazhimi deklarativ i Thaçit nëpër paraqitjet e tij para medias ishte depolitizimi,

fortësimi, privatizimi i kompanive publike. Shumë shpejt pas ardhjes në zyrë Thaçi dhe kabineti i tij i shpallën jolegjitime bordet e kompanive publike të përbëra tashmë nga ish-ministrat me qëllim që t'i reformojnë ato me ekspertë dhe njerëz kompetentë në vend të ministrave siç ishte në qeverinë e kaluar që përgjithësisht ishin të dyshimt si të korruptuar.

Përsa i përket depolitizimit të ndërmarrjeve publike i premtuar në mënyrë pompoze nga Thaçi praktika e ndjekur nga qeveria e tij në një masë të konsiderueshme e ka demantuar përkushtimin e shprehur në deklaratat. Në të vërtetë ai ka marrë vendimin që të mos dërgojë ministra në bordet e kompanive publike dhe të AKM-së por e ka shkelur tërësisht premtimin se në këto borde do të dërgojë profesionist të pavarur. Ajo që në të vërtetë ndodhi përgjithësisht është një pamundësi e qeverisë që t'iu qëndrojë parimeve që i proklamoi. Përveç Bordit të KEK-ut nuk u plotësua tërësisht asnjë bord tjetër i kompanive publike. Në Bordin e KEK-ut u emëruan ekspertë edhe pse aktivistë tashmë të njohur të PDK-së. Bordi i AKM-së u vërshua nga njerëz politik dhe në konflikte klasike interesi.

KEK: përplot akuza por pa plan

Në anën tjetër KEK-u dhe disa kompani tjera publike u shndërruan si një shënjestër për qitje për kryeministrin Thaçi sa herë që ai kishte nevojë ta bind publikun që është kundër korrupsionit. Në praktikë ajo që ndodhi ishte një shou publik me deklaratat të forta dhe një abstenim total i qeverisë për t'iu involvuar për zhblokimin e situatës dhe zgjidhjen e problemeve në këtë sektor. Në asnjë moment nuk është parë kush nga qeveria t'iu mësyen zyra të divizioneve të KEK-ut ose të drejtorisë së saj edhe pse ata ishin akuzuar deri në kualifikimin për sabotazhë. Qeveria lansoi herë pas here informacione nëpër shtypin nën ndikim të tyre se janë duke u sabotuar nga ish-ministri Et'hem Çeku, por kjo nuk ngeli veç se një tentim për t'iu shfajësuar për krizën energjetike duke qenë se në asnjë moment nuk u tregua një fakt apo një logjikë që tregon se ku dhe si po ndodhë sabotazhi. Mbi të gjitha, qeveria edhe pas 100 ditë pune praktikisht nuk ka akoma ndonjë përgjigje si të luftojë korrupsionin dhe keqmenaxhimin në KEK përtej drejtimit të gishtit drejt menaxhmentit të kësaj kompanije.

Plani për përmirësim të furnizimit me energji elektrike i kësaj qeverie nuk ka ndryshuar shumë nga e kaluara. Në fakt kjo qeveri nuk ka paraqitur kurrfarë plani për zgjidhjen e problemit të mungesës së rrymës në Kosovë, edhe pse një prej premtimeve më pompoze të zotit Hashim Thaçi gjatë fushatës elektorale ishte furnizimi me rrymë 24 orë në ditë. Planet e vetme janë ato afatgjata që janë të lidhura me ndërtimin e kapaciteteve të reja energjetike, gjegjësisht me projektin Kosova C2100. Edhe pse kjo qeveri ka premtuar se do të ketë një transparencë më të madhe në lidhje me këtë projekt dhe do të bëjë një ndryshim të këtij projekti që do të nënkuptonte reduktim të kapaciteteve të projektuara, ajo as sot e kësaj dite nuk e ka bërë të qartë çfarë do të bëjë me këtë projekt. Në këtë formë qeveria është duke vazhduar të thyej dokumentet e Kuvendit të Kosovës që përcakton qartë se deri në ç'masë mund të shkohet me kapacitete të reja të prodhimit me linjit. Poashtu qeveria është duke bërë shkeljen e dokumentave ndërkombëtare që rregullojnë fushën e investimeve që kanë pasojë në ambient siç është për shembull

Konventa Aarhus për të drejtën e opinionit për të ditur dhe për të marrë pjesë në vendimmarrje për programe ekonomike që do të kenë pasoja në ambient.

PTK: pa zot shtëpie

Kompania tjetër më e madhe publike, PTK, për këto 100 ditë të qeverisjes së Thaçit ngeli pa menaxhment në kohën kur më së shumti i duhej për shkak të presioneve që sillte konkurrenca jolojale në treg nga një operator jopublik që po shfrytëzonte ndikimin e vendosur qysh me kohë mbi një pjesë të politikës gjatë tenderimit për frekuencat për operator të dytë të telefonisë mobile që ndodhi në verën e vitit 2007. Qeveria aktuale nuk e plotësoi Bordin e PTK-së dhe la këtë kompani pa menaxhment duke i shkaktuar një hendikep të madh në zhvillim të mëtutjeshëm të shërbimeve dhe ofertave për gati një milionë konsumatorë. Në këtë formë ajo i krijoi një mundësi më të madhe operatorit të dytë të telefonisë mobile që nëpërmjet ndikimit në autoritetin tashmë të korruptuar që rregullon këtë treg, ART, të fitojë treg në mënyrë jolojale madje edhe duke arbitruar çmime që mbrojnë interesin e operatorit jopublik në dëm të lojalitetit në treg dhe në dëm të interesit të operatorit publik. Në këtë formë duket se filloi një skenar shumë tipik i dëmtimit të një korporate publike duke e përgatitur atë potencialisht për t'ia servuar në pjatë korporatës jopublike në mënyrë që sërish të vendoset një lloj monopoli në treg. Në këtë funksion duket të ketë qenë edhe vendimi i Qeverisë për të dërguar në Bordin e AKM-së njërin nga aksionarët e IPKO Telecommunications, zotin Dino Asanaj, në një konflikt të pastër interesi.

Zgjedhjen e drejtorit menaxhues të PTK-së, me gjithë përpjekjet, qeveria nuk arriti dot ta vejë në rrugë të mbarë. Anëtari i Bordit të PTK-së, Edmond Hajrizi, u fut në një garë për drejtor të PTK-së me sigurinë paraprake se do ta fitonte garën. Për t'u siguruar në këtë, Hajrizi kishte ndikuar tek Bordi i PTK-së që të ndaj jo më pak se gjysmë milioni euro për një konsulencë ndërkombëtare e cila do ta ndihmonte bordin në përzgjedhjen e drejtorit menaxhues të PTK-së. Si për "befasi" ky komision i paguar nga Bordi i PTK-së nxori një anëtar bordi si kandidatin më të mirë për drejtor menaxhues, zotin Hajrizi. Vendimi i Ministrisë të Transporteve dhe Telekomunikacionit, zotit Fatmir Limajt, në këtë rast, pa marrë parasyh motivimet, ishte pozitiv dhe vendimtar për të parandaluar zgjedhjen e drejtorit në baza krejtësisht të korruptuara. Mirëpo veprimet e mëtutjeshme të qeverisë nuk përmirësuan gjendjen. PTK vazhdon të jetë pa drejtor menaxhues dhe pa Bord drejtues. Në ndërkohë një pjesë e menaxhmentit të PTK-së janë blerë nga operatori privat i telefonisë mobile, IPKO Telecommunications dhe sot ata punojnë për këtë kompani. Organizata ÇOHU! në një studim rekomandues i pat sygjerruar qeverisë në fillim të mandatit që të ndërmarrë masa mbrojtëse për operatorin publik të telefonisë mobile duke i krijuar mundësinë e motivimit më të madh të punonjësve dhe në evitimin e pasigurisë për të ardhmen e tyre.¹ Sot PTK edhe pse kompania më e madhe kosovare publike ka ngelur në mëshirë të fatit pa një strukturë menaxhuese që do të merrte përsipër vendimet që përmbajnë në vete çfarëdo risku.

¹ Shih "Rekomandime për Integritet Institucional", përgatitur nga Organizata ÇOHU! për Qeverinë Thaçi pas krijimit të saj në janar 2008.

http://www.cohu.org/raporte/Rekomandime_Per_QeverineThaci_COHU_Final.doc

Në anën tjetër tregu i telekomunikacionit ka ngelur tërësisht i korruptuar që nga koha e organizimit të tenderit të dytë të telefonisë mobile. Bordi i Autoritetit Rregullativ të Telekomunikacionit nuk është konstituuar ndonjëherë edhe pse në vazhdimësi një grup njerëzish me në krye kryetarin Anton Berisha kanë marrë vendime të rëndësishme për këtë treg në Kosovë. Vendimet e këtij autoriteti kanë qenë vazhdimisht të njëanshme dhe zakonisht kanë paraqitur mbrojtjen e Mobilkom Slovenija dhe partnerëve të tjerë të saj kosovar si Ekrem Lluka. Edhe pas shpalljes bartës të licensës së operatorit të dytë në një proces thelbësisht të korruptuar, ART, gjegjësisht shefi i saj Anton Berisha kanë marrë vendime për caktimin e çmimit të tarifave në favor të operatorit të dytë dhe askush nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim. Heshtja e PDK-së rreth këtyre shkeljeve të ART-së pat bërë Organizatën ÇOHU! që të akuzojë zotin Thaçi për korrupsion në kohën kur ai ishte opozitë. Vendosja e një aksionari të IPKO Telecommunications si përfaqësues të qeverisë së udhëhequr nga Thaçi në AKM vërteton se shqetësimet e ngritura verën e vitit 2007 nga Organizata ÇOHU! kanë pasur mbështetje. As sot e kësaj dite kjo Qeveri nuk e ka bërë as më të voglin hap për të vendosur ligjin në kamoin e ART-së, e cila vazhdon të jetë një autoritet i lidhur dhe i përkufizuar me shefin e saj, Anton Berishen.

ANP: zëvendësimi me struktura lojale

Për një kohë të gjatë në Aeroportin e Prishtinës janë shtresuar probleme e vepra të kundërligjshme. Menaxhmenti i kësaj kompanie ka pasur rotacione, por esencialisht struktura që kishte bërë shkelje tashmë të argumentuara e të faktografuara kishin ngelur po aty. Duke qenë nën mbrojtje të fortë të përfaqësuesit të AKM-së për ndërmarrjet publike, sidomos nën mbrojtjen e zotit Ilir Salihut, menaxhmenti i Aeroportit kishte përballuar në vazhdimësi presionin publik që ishte bërë për shkak të veprave të dyshimta penale që kishin kryer menaxhmenti për një kohë të gjatë sidomos nga viti 2003 e këndej. Edhe Aeroporti i Prishtinës ishte me të drejtë në listën e zezë për korrupsion të bërë nga kryeministri Thaçi. Madje Aeroporti i Prishtinës ishte mbase edhe suksesi i vetëm mbas deklarimeve të famshme të kryeministrit kur i shpalli kompanitë publike kampionë të korrupsionit. U burgos drejtori menaxhues i kësaj kompanie dhe shefi i zyrës së prokurimeve së bashku me pronarin e Petrol Company si të dyshuar se ishin të përfshirë në korrupsion në lidhje me furnizimin me karburante të Aeroportit dhe në kontrata të tjera të dhëna nga menaxhmenti i ANP-së. Sido që të jetë, shpejt u pa se Qeveria kishte për qëllim menjanimin e kësaj strukture në Aeroport për ta zëvendësuar atë me një strukturë tjetër që do t'i bindet direkt asaj. Emërimi si ushtrues detyre të drejtorit menaxhues i një njeriu familjarisht të afërt me PDK-në ka treguar se objektivi i kësaj fushate është thjesht zëvendësimi i strukturave lojale, por jo vendosja e profesionalizmit dhe meritokracisë e të mirëmenaxhimit si kritere.

Privatizimi pa rezultate

Raporte dhe propaganda mediale të AKM-së flasin për një ngjallje të ekonomisë si rezultat i drejtpërdrejt të privatizimit dhe investimeve nga pronarët e rinjë privat. Nëse kjo është situata, cili është rezultati i privatizimit dhe për çfarë realizimesh të investimeve flasin raportet e AKM-së? Deri më tani, akoma nuk është vënë re asnjë ndryshim në parametrat makroekonomik të cilët vazhdonë të flasin për një ekonomi të dobët, varfëri të madhe dhe papunësi rekord. Burime të ndryshme tregojnë se Kosova akoma ka një varfëri absolute mes 46 e 48%, varfëria ekstreme vazhdon të ngel në nivelin 18%,

papunësia së paku 46%, kurse defiçiti tregtar në vend të tendencës për t'u zvogëluar si rezultat logjik i privatizimit, nuk ka rënë asnjëherë nën 95%, por, përkundrazi, herë herë ka pasur tendenca rritjeje.²

Asnjë qeveri e Kosovës nuk ka pasur ndonjë plan për ta parë se si qëndron puna me kompanitë e privatizuara. Programet e përgjithshme të qeverisë nuk përfshijnë nevojën për vlerësimin e procesit të privatizimit dhe të realizimit të obligimeve të investuesve edhe përkundër faktit se ka tepër shumë ankesa nga punëtorët. Akoma nuk ka ndonjë plan për problemin e obligimit të pagesës për punëtorët të 20% të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Kuota e të punësuarve kryesisht është arritur gati në të gjitha ndërmarrjet e privatizuara me spin off special, por shumë shpesh punëtorët janë të paguar më pak sesa paga minimale dhe kushtet e punës janë tepër të vështira madje ka edhe shkelje të të drejtave të tyre të garantuara me ligj.

Akoma nuk është parë një plan i Qeverisë për të adresuar këto aspekte, të cilat do të kenë një rëndësi tepër të madhe jo vetëm për zhvillim ekonomik dhe luftim të varfërisë e papunësisë, por edhe për një paqe më të qëndrueshme sociale dhe për sigurinë në tërësi.

ADMINISTRATA PUBLIKE: TRADITA (E POLITIZIMIT) VAZHDON

Ndërtimi i administratës publike të paanshme, jopolitike dhe profesionale është kërkesa elementare për çdo vend që synon integrimin në BE. Është e qartë se qeveritë e mëparshme kanë manipuluar politikisht administratën duke bërë madje që në poste të përcaktuara si strikte civile të vendosen njerëz partiak madje edhe me funksione të rëndësishme në parti. Lidershipi që gjendet në pushtet aktualisht pat premtuar se nuk do të ketë hakmarrje politike, por raste të zëvendësimeve të zyrtarëve civil me aktivistë të partive në pushtet ka pasur gjatë këtyre 100 ditëve. Mënyra e zëvendësimit të këtyre zyrtarëve të lartë civil nuk përkon me kodin dhe procedurat e shërbimit civil. Shumë shpesh këta zyrtar shkarkohen për t'u zëvendësuar me aktivistë tjerë partiak me ose pa ndonjë konkurs paraprak. Për shembull konkursi për drejtor të ATK-së ka nxjerrë si udhëheqës një ish-kryetar dege të PDK-së. Ushtruesja e detyrës së drejtorit të Agjensionit për Integritet Evropian është mbesa e nënkryetarit të PDK-së, Xhavit Halitit. Punonjës të administratës tregojnë për shumë raste kur në administratë që nga ardhja e kësaj qeverie janë parashutuar njerëz nëpër zyra të shërbimit civil në baza nepotike. Zyrtarët e Zyrrave të Informimit në Zyrrë të Kryeministrit dhe Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale janë zëvendësuar nga individë të afërt me PDK-në.³

Në anën tjetër afinitetet politike kanë bërë që partitë në pushtet të mbyllin sytë edhe para fakteve dhe dyshimeve për përfshirje në korrupsion të kandidatëve të caktuar për poste civile e menaxhuese në sektorë të rëndësishëm publik. Institucionet tjera që kanë qenë viktimë e një qasjeje të tillë të kësaj qeverie janë edhe Administrata Tatimore e Kosovës dhe Autoriteti Qendror Bankar. Ish-kryetari i degës së PDK-së për Podujevë, Naim Fetahu, është emëruar drejtor i ATK-së, një praktikë kjo shumë shpesh e përcjellur nga qeveria e kaluar dhe e kritikuar fort nga lidershipi i tashëm në pushtet. Në të njëjtën kohë është emëruar drejtor i AQB-së një person për të cilin gjerësisht është raportuar për

² Shih uebfaqen e Bankës Botërore në Kosovë: <http://www.worldbank.org/kosovo>

³ Shtypi ditor kosovar me 20 dhe 26 mars 2008.

dyshime për korrupsion, zoti Hashim Rexhepi. Një letër e shpërndarë për deputetët e Parlamentit të Kosovës dhe e botuar në shtyp ka nxjerrë dyshime se derisa bënte detyrën e zëvendës-drejtorit të AQB-së dhe në Entin e Statistikave të Kosovës ishin ngritur dyshime për korrupsion. Parlamenti i Kosovës, gjegjësisht deputetët e partive në pushtet, kanë injoruar këto dyshime dhe pa ndonjë verifikim kanë votuar për emërimin e zotit Rexhepi drejtor i AQB-së.

Thaçi është zotuar edhe se do t'i marrë seriozisht raportet e ZAGJ gjegjësisht auditimet të cilat në të kaluarën kanë nxjerrë shkelje serioze pothuajse në secilën organizatë buxhetore. Në një takim me drejtoreshën e ZAGJ-it Linda Casela, Thaçi pat deklaruar se raportimet e Auditorit nuk do të ngelin vetëm fakte të vdekura në letër. Ajo që ka ndodhur në të vërtetë është se zyrtarë për të cilët Auditori Gjeneral ka raportuar për shkelje serioze janë angazhuar nga kjo qeveri madje pikërisht në fushat më të ndjeshme siç është zyra e prokurimit. Shefi aktual i zyrës për prokurime në Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacionit, Nexhat Krasniqi, ka qenë i dyshimt për shkelje serioze dhe raporti i auditorit i ka mbështetur këto dyshime derisa ai ishte shef i prokurimit në Ministrinë e Tregtisë e Industrisë. Po kështu ka ndodhur me shefin aktual të Zyrës së prokurimeve në Ministrinë për Shërbime Publike.

ARSIMI I LARTË: FUSHA E SUPERMENAVE

Arsimi kosovar vazhdon të jetë i mbytur me probleme të shumta, të trashëguara dhe të zhvilluara gjatë tetë viteve të fundit. Politizimi, kualiteti i dobët i mësim-dhënies, plagjiaturat e profesorëve universitarë, numri i lartë i universiteteve private pothuajse pa kurrfarë cilësie, numri shumë i lartë i studentëve në raport me numrin e profesorëve, janë disa prej problemeve që rëndojnë më së shumti arsimin kosovar, sidomos atë të nivelit të lartë.

Në drejtim të përmirësimit të situatës në arsim, disa hapa pozitiv janë ndërmarrë nga qeveria e re, konkretisht nga ministri i arsimit zoti Enver Hoxhaj, të cilët mbetet të shihet sesi do të realizohen. Një prej këtyre hapave, edhe pse jo me shpejtësinë e duhur, është funksionalizimi i Agjencisë për Akreditim dhe përbërja e tij me staf ndërkombëtar që të sigurohet objektivitet në vlerësimin e përmbushjes së kriterëve për akreditim nga institucionet e arsimit të lartë. Ngrirja e pozicionit të tij si profesor në Universitetin e Prishtinës nga ministri Hoxhaj për të shmangur konfliktin e interesit gjatë procesit të akreditimit, poashtu është një hap pozitiv dhe i rrallë në politikën kosovare që duhet të shërbejë si shembull për zyrtarët e tjerë qeveritarë.

Këto janë dy hapat e parë në drejtimin e duhur që vendosin bazat për rregullimin e tregut dhe cilësisë së arsimit të lartë në Kosovë, por që duhet të përcillen nga hapa të tjerë të vendosur. Duke pasur parasysh ndikimin politik të vendosur nga një numër i madh i universiteteve private është urgjente vendosja e kriterëve bashkëkohore në institucionet edukative siç janë paanshmëria dhe depolitizimi i procesit të akreditimit të universiteteve private. Një numër i ministrave kanë qenë profesorë në disa prej universiteteve private dhe disa nga pronarët e universiteteve private janë biznesmenë të fuqishëm që kanë lidhje të afërta me politikën kosovare, kjo mund të ndikojë që procesi të politizohet dhe të jetë selektiv në akreditimin e universiteteve private. Në fakt, depolitizimi i këtij procesi dhe

mbajtja e tij larg ndikimeve politike do të jetë shumë e vështirë pasi që këta biznesmenë janë pjesë e strukturave politike në mënyrë direkte ose indirekte dhe ata do të shfrytëzojnë ndikimin e tyre që bizneset e tyre për prodhimin e diplomave pa vlerë të vazhdojnë të funksionojnë pa u penguar. Kryeministri Hashim Thaçi dhe e tërë qeveria e tij duhet ta mbështesin fuqimisht ministrin Hoxhaj dhe vetë ministri duhet të tregojë vendosshmëri dhe guxim në mbylljen e atyre universiteteve private, rezultati i vetëm i të cilave deri më tani ka qenë krijimi i një kaosi arsimor ku ka humbur domethënia dhe vlera e shkollimit të lartë.

Organizata ÇOHU! do ta monitorojë këtë proces dhe do të dalë me një vlerësim të vetin rreth paanshmërisë dhe depolitizimit në akreditimin e universiteteve private dhe respektimit të kriterëve akademiko-shkencore.

Super ministrat-profesorë

Gjykuar sipas titujve akademiko-shkencor, kjo qeveri mund të quhet Qeveria e “Profesorëve e Doktorëve” dhe sipas kësaj formule të përbërjes qeveritare Kosova do të duhej të ishte vendi me perspektivën më premtuese të zhvillimit në rajon. Mirëpo, situata është ndryshe nga ç’paraqitet! Disa ministra të Qeverisë Thaçi, me gjithë kërkesën e shefit të tyre që ishte ndër kërkesat e para pas krijimit të qeverisë, nuk kanë ndërprerë punën e tyre si profesorë në universitetin publik të vendit, duke dëmtuar kështu edhe kualitetin e mësim-dhënies edhe të punës si ministra.⁴ Edhe pse këta ministra deklarojnë se nga UP-ja paguhen me honorar si punë të dytë dhe se punë të tyre parësore e kanë punën si ministra, megjithatë këtu duhet bërë një vlerësim nga aspekti normativ. Çështja nuk është vetëm a po e respektojnë ministrat ligjin por sa mund të jenë ata efektiv në punën e tyre si ministra dhe si profesorë njëkohësisht? A mundet Kosova t’ia lejojë vetit luksin e ministrave-profesorë në një situatë kur varfëria e përgjithshme shkon deri në 50 përqind, papunësia sillet prej 40 deri në 60 përqind, ndërsa arsimi është në gjendje pothuajse të pashpresë? Domosdoshmërisht angazhimi i dyfisht si ministër-profesor do të ketë si pasojë dështimin e dyfisht.

Hulumtimi i Organizatës ÇOHU! tregon se studentët e UP-së tashmë po i vuajnë pasojat e këtij angazhimi të dyfisht. Ministrat-profesorë si Justina Pula – Shiroka, Hajredin Kuçi, Arsim Bajrami, zëvendës-ministri i arsimit Agim Hyseni, zëvendës-ministri i energjetikës Blerim Rexha si dhe disa nga këshilltarët e kryeministrit Thaçi si Astrit Salihu, Blerim Latifi e Bekim Çollaku, janë parë rrallë ose hiç në ligjërata me studentë prej emërimit të tyre në këto poste. Në fakt, sipas studentëve shumica e këtyre ministrave-profesorë nuk kanë qenë të rregullt në ligjërata edhe para se të emëroheshin si ministra. Të vetmit ministra që kanë ngrirë pozicionet e tyre si profesorë janë Enver Hoxhaj dhe Ahmet Shala, të cilët duhet përkrahur për këtë veprim që shkon drejt vendosjes së parimeve të integritetit në institucione.

⁴ Organizata ÇOHU! në raportin e saj “Rekomandime për Integritet Institucional” të datës 19 janar, 2008, i kishte tërhequr vërejtjen kryeministrit Thaçi se kredibiliteti i qeverisë së tij por edhe efektiviteti i qeverisjes dhe mësim-dhënies cenohet nga mbajtja e disa posteve nga ministrat e tij, sidomos nga ata që vazhdojnë të jenë edhe profesorë në UP.

Ndërsa, zëvendës-kryeministri Hajredin Kuçi ka edhe më shumë përgjegjësi sesa vetë kryeministri i Kosovës duke kryer njëkohësisht punën të cilën e ka të përshkruar sipas zyrës që mban, por edhe të përgjegjësit të qeverisë së Kosovës për media, të përfaqësuesit të partisë së tij në Kuvendin e Kosovës⁵, dhe deri vonë ka qenë edhe kryetar i Komisionit Kushtetues. Është e vështirë të besohet se me gjithë këto përgjegjësi, zëvendës-kryeministri Kuçi është në gjendje të përkujdeset edhe për studentët e tij në Fakultetin Juridik dhe në Shkencat Politike. Kjo shumëfishësi e përgjegjësive e kishte bërë Organizatën ÇOHU! që në një moment zëvendës-kryeministrin Kuçi ta cilësojë si “supermen”.

Është e qartë se mbajtja e pozitave si profesorë e ministrave dhe stafit tjetër politik ka dëmtuar studentët e Universitetit të Prishtinës të cilët nuk paguajnë shuma të vogla për shkollim në këtë institucion publik. Në të njëjtën kohë, këta ministra dhe këshilltarë nuk janë shquar as në postet e tyre për ndonjë veprim që ia vlen të përmendet gjatë këtij 100 ditëshi. Një prej premtimeve të para të kryeministrit Thaçi pas krijimit të qeverisë së tij ka qenë që autoritetet që janë të zgjedhura në qeverinë e Kosovës do të fokusohen vetëm në punët e qeverisë duke i lënë detyrat e tjera.⁶ Deri tash qartazi kjo kërkesë e kryeministrit nuk është respektuar nga ministrat dhe këshilltarët e tij, duke bërë publikun kosovar që të dyshojë në autoritetin dhe aftësinë e tij për të vënë në jetë premtimet dhe vendimet e tij si kryeministër i vendit.

Profesorët shkelin ligjin

Përveç që kanë dëmtuar studentët dhe nuk kanë treguar rezultate në politikë për këto 100 ditë të para, mbajtja e posteve të profesorëve nga stafi politik është edhe shkelje e rregullores mbi Shërbimin Civil në Kosovë, 2001/36. Neni 4 i kësaj rregulloreje, nën paragrafin ‘Aktiviteti politik’, saktëson se “Nëpunësit civilë kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike dhe të organizatave të tjera politike, por duhet të pëmbahen nga angazhimi i tyre aktivë në aktivitetet politike.”⁷ Sipas kësaj rregulloreje, me nëpunës civil nënkuptohen të gjithë të punësuarit që marrin rrogë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, ku përfshihen edhe profesorët universitarë. Kështuqë nëpërmjet angazhimit të tyre politik, ministrat dhe këshilltarët-profesorë janë duke bërë edhe shkelje të ligjit. Kryeministri Thaçi duhet të ndërhyj nëse e ka seriozisht luftimin e keqmenaxhimit, vendosjen e sundimit të ligjit dhe instalimin e parimeve të qeverisjes së mirë në institucione. Përndryshe, ky do të jetë edhe një dështim i kësaj qeverie.

Politizimi i UP-së

Marrë parasysh se një numër i madh i profesorëve të Universitetit të Prishtinës janë edhe anëtarë aktiv në Partinë Demokratike të Kosovës dhe se kjo parti tash udhëheq me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, është pak e besueshme se këta ministra-profesorë do të gjinden në ndonjë presion të fuqishëm nga kryeministri për të “liruar” UP-në. Kjo bëhet aq më pak e besueshme sidomos duke marrë parasysh trendin

⁵ Edhe pse kjo jozyrtarisht, Kuçi ka qenë avokati i politikave të kryeministrit Thaçi dhe PDK-së në Kuvendin e Kosovës duke lënë nën hije shefin e grupit parlamentar të kësaj partie, Ramë Buja.

⁶ Gazetat ditore të datës 6 mars, 2008.

⁷ Uebfaqja zyrtare e UNMIK-ut, Gazeta Zyrtare

http://www.unmikonline.org/albanian/regulations/2001/RA2001_36.pdf

që ka marrë krye në qeverinë e re për të zëvendësuar njerëzit e qeverisë së kaluar me njerëz të vet. Ekziston rreziku imediat që PDK të monopolizojë tërësisht sektorin i cili më së paku duhet të jetë i kontrolluar nga politika dhe i cili ka nevojë urgjente që të reformohet rrënjësisht. Unionet e ndryshme të studentëve të UP-së shpesh janë manipuluar nga politika për qëllime politike.

Politizimi i sektorit publik dhe lufta politike mes partive kosovare për marrjen nën kontroll të sektorëve dhe burimeve të ndryshme financiare është një prej problemeve me implikime të gjëra dhe afatgjate që do të paraqesin pengesa serioze për zhvillimin e Kosovës. Qeveria e kaluar kishte politizuar administratën publike, Administratën Tatimore të Kosovës, Bordet e Ndërmarrjeve Publike, kishte influencuar privatizimin dhe kontrollonte tenderët që kishte rezultuar me akumulimin e fuqisë politike dhe ekonomike në duar të disa individëve. Kjo qeveri duhet të depolitizojë këto institucione jo duke i zëvendësuar me njerëz të vet por me profesionistë dhe duke parë interesin e përgjithshëm.

SHËNDETËSIA E PARTIZANËVE

Në përgjithësi, sektori i Shëndetësisë ka qenë i ngërthyer nga struktura politike që kanë punuar për përfitime personale dhe partiake. Qeveritë e kaluara në vazhdimësi kanë instaluar njerëz lojal politik në postet kyçe të këtij sektori me qëllim të manipulimit të tenderëve në barna dhe pajisje mjekësore, duke manipuluar procesin e kualifikimit e specializimit të kandidatëve dhe duke ndërtuar një sistem politik e nepotik të punësimit në sektorin publik të shëndetësisë.

Me ardhjen në pozitë si ministër i shëndetësisë, Alush Gashi u zotua publikisht se çdo ditë tjetër, gjendja në këtë sektor do të shkonte duke u përmirësuar. Ai premtoi rend dhe ligj, përmirësim të kualitetit të kujdesit shëndetësor në Kosovë, dhe kujdes të veçantë për Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë. Përkundër deklaramit publik të ministrit Gashi në shkurt të këtij viti se qeveria ka program, dhe në këtë logjikë edhe Ministria e Shëndetësisë, ky program nuk u bë publik asnjëherë, por logjika partizane e udhëheqjes së qeverive të kaluara vazhdoi me të njëjtin ritëm.

Që në ditët e para si ministër i shëndetësisë, ministri Gashi përfshihet në luftë politike me qëllim të qërimit të hesapeve dhe hakmarrjeve personale dhe politike me ish-Sekretarin e Përhershëm Ilir Tolaj dhe drejtorin e QKUK-së Isuf Ulaj. Përkundër skandaleve dhe kundërthënies lidhur me punën e Ilir Tolaj i cili gjithashtu njihet si i afërt me AAK-në fokusimi në shkarkimin e tij nga ministri Gashi ishte rast tipik i hakmarrjes personale. Ilir Tolaj gjatë mandatit të tij kishte shkarkuar vëllaun e Ministrit Gashi, Afrim Gashin, nga posti i drejtorit të klinikës interne në QKUK. Më pas, Gashi punëson vëllaun e tij këshilltar personal, dhe nipin e tij këshilltar të lartë të ministrit.

Në QKUK tashmë pothuajse nuk ekziston kurrfarë forme e komunikimit të brendshëm, dhe si rrjedhojë kjo ka shkaktuar çarje në funksionimin edhe ashtu të dobët të menaxhmentit brenda QKUK-së. Kjo u dëshmuar me vizitën e parë të ministrit Gashi në QKUK dhe refuzimi i tij që të takohet me drejtorin Isuf Ulaj dhe menaxhmentin e kësaj qendre. Mënyra e tillë e sabotimit dhe e zëvendësimit të posteve kyçe nga ministri Gashi

është përgatitje e terrenit për shkarkime të mëtutjeshme dhe zëvendësim i tyre me njerëz lojal farefisnor dhe partiak.

Fushatën të cilën e ka ndërmarr ministri Gashi për të pastruar strukturat të afërta me politikën në Shëndetësi është thikë me dy teha. Në njërin anë, në opinion krijohet përshtypja se ministri Gashi është i vendosur që të spastrojë shëndetësinë nga strukturat e kriminalizuara në sektorin e shëndetësisë, por, në anën tjetër, këto poste vetëm se po zëvendësohen me njerëz lojal farefisnor dhe partiak të ministrit Gashi, në mënyrë jotransparente, pa konkurse dhe duke bërë shkelje të qartë të ligjit.

Fokusimi i ministrit Gashi në luftë politike në zëvendësimin e posteve të rëndësishme në MSH me njerëz partiak apo farefisnor ka ndikuar në përshkallëzimin e mëtejshëm të gjendjes edhe ashtu të mjerë në QKUK. Aty vazhdojnë të mungojnë barnat esenciale, filmat për fotografime rëntgen dhe kujdesi elementar, duke rrezikuar seriozisht shëndetin e pacientëve në këtë qendër. Programi qeveritar për shëndetësinë për këto 100 ditët e para duket se ka qenë zëvendësimi i partizanëve të qeverisë së kaluar me partizanë të vet.

Përkundër retorikës së ashpër antikorrupsion të kësaj qeverie, një rast tipik i shkeljes së ligjit dhe tolerimit të korrupsionit ndodhi gjatë përzgjedhjes së kandidatëve për specializim pikërisht gjatë ditëve të para të Gashit si ministër i shëndetësisë. Komisioni i caktuar për të hulumtuar tërë procesin e përzgjedhjes doli publikisht më datën 15.02.2008 me konkluzione se i tërë procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për specializim ishte i përshkuar me shkelje të rënda të ligjit dhe korrupsion. Ministri Gashi u deklarua publikisht se do të hetohej ky proces dhe ligji do të vihej në rend dhe se gjithçka do të ishte transparente. Kur pritej të bëheshin transparente rrethanat në këtë skandal me një vendim të brendshëm, ministri Gashi toleroi shkeljet e ligjit duke lejuar që kjo listë të legjitimohej. Në këtë listë është edhe vajza e këshilltarit të Ministrit Gashi, Safa Rexhep Boja, e cila qartazi ka poena më pak se kandidatët të cilët janë refuzuar. Në këtë listë gjithashtu ka fëmijë të tjerë të drejtorëve të departamenteve të ndryshme brenda MSH-së, këshilltarëve dhe stafit mjekësor të QKUK-së.

KONKLUZION

Këto 100 ditët e para të Qeverisë Thaçi karakterizohen me retorikë të ashpër kundër korrupsionit, në njërin anë, dhe me tolerim të vrazhdë të korrupsionit, në anën tjetër. Në esencë, kjo është një luftë e ashpër politike për t'i zëvendësuar partizanët e qeverisë kaluar me partizanët e kësaj qeverie. Përkushtimi i shprehur në retorikë për të luftuar korrupsionin i përdorur gjerësisht nga zoti Thaçi dhe mungesa e rezultateve substanciale për këtë periudhë 100 ditëshe do të mund të haste në mirëkuptim për shkak të kohës së kufizuar dhe angazhimeve rreth statusit. Mirëpo, kur kihen parasysh vendimet e veprimet e kësaj qeverie që me qëllim favorizojnë konflikt interesi, korrupsion, politizim të ndërmarrjeve dhe institucioneve, mund të konstatohet lirisht se fushata për luftimin e korrupsionit ka qenë e orientuar më shumë nga ideja e zëvendësimit të strukturave të mëhershme, që dorën në zemër kanë qenë gjerësisht të dyshuara si të korruptuara, me struktura që do t'i përgjigjeshin interesit partiak e politik të pushtetit të sotshëm.

APPENDIX I

Infrastruktura Ligjore dhe Institucionale kundër korrupsionit

Krijimi i infrastrukturës kundër korrupsionit domosdoshmërisht duhet të përmbaj tri elemente esenciale: vullnetin politik, infrastrukturën adekuate dhe efektive ligjore si dhe atë institucionale, po që se ndonjë iniciativë për parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni synon që të ketë sukses. Në këtë kontekst, në praktikë deri më tani kanë munguar të tri këto elemente esenciale.

Mungesa e vullnetit politik ka bërë që përpjekjet kundër korrupsionit, deri më tani, të mos rezultojnë me krijimin e një infrastrukture ligjore dhe institucionale të aftë që të ofroj një bazë efektive brenda së cilës do të mund të kontrollohej shtrirja e korrupsionit. Në realitet, iniciativa për themelimin e infrastrukturës ligjore dhe institucionale ka rezultuar si pasojë e presionit të jashtëm, e jo si përpjekje e faktorit vendor për krijimin e një infrastrukture efektive kundër korrupsionit. Strategjia si dhe Ligji kundër Korrupsionit kanë qenë disa nga pikat e Standardeve⁸ që kosovarët është dashtë t'i përmbushin. Për më shumë, themelimi i Agjensionit Kosovarë kundër Korrupsionit edhe pse i paraparë për tu krijuar me Ligjin kundër Korrupsionit, ka ardhur si rezultat i presionit të Grupit të Kontaktit⁹. Përkundër kësaj, pjesa dërmuese e objektivave të përcaktuara në Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër Korrupsionit nuk janë përmbushur kryesisht si pasojë e mungesës së vullnetit politik¹⁰. Në këtë vijë, me gjithë aprovimin e Ligjit kundër Korrupsionit si dhe themelimin e Agjensionit Kosovarë kundër Korrupsionit, përpjekjet për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit kryesisht kanë dështuar. Kjo ka rezultuar për shkak se as Ligji kundër Korrupsionit e as institucionet të cilat në mënyrë (in)direkte parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin nuk ofrojnë kornizë adekuate dhe efektive kundër korrupsionit¹¹. Si pasojë e kësaj, barra për luftën e korrupsionit i lihet veçanërisht Agjensionit Kosovar kundër Korrupsionit, ndërsa as kompetencat dhe as resurset e saj financiare dhe profesionale nuk i mundësojnë kontrollin, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Fakti i dështimit të luftës kundër korrupsionit mund të shihet edhe nga të dhënat statistikore që kanë të bëjnë me rastet e dyshuara të korrupsionit që prokuroritë dhe gjykatat deri më tani i kanë shqyrtuar dhe përmbyllur¹². Kështu që, deri më tani përpjekjet për luftim të korrupsionit dhe krimin të organizuar kanë qenë të kota kryesisht si pasojë e mungesës së vullnetit politikë.

Megjithëkëtë, përkundër faktit që koalicioni i tanishëm në krye me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK), ka filluar qeverisjen me premtimin për ta luftuar korrupsionin, në realitet po ndodhë e kundërta. Përkundër shkeljeve të deri tanishme të kësaj qeverie të argumentuara në këtë raport, kjo qeveri me veprimet e saja karshi krijimit të infrastrukturës shtesë ligjore dhe institucionale tregon që nuk ka një strategji për luftimin e korrupsionit, por punën e saj e bazon në qasje ad-hoc.

⁸ http://www.unmikonline.org/pub/misc/ksip_eng.pdf

⁹ Shih "Rekomandime për Integritet Institucional" – ÇOHU!- Janar 2008.

http://www.cohu.org/raporte/Rekomandime_Per_QeverineThaci_COHU_Final.doc

¹⁰ Shih "Monitorimi i Përgjigjeve Ligjore në Rastet e Korrupsionit" – ÇOHU! – Mars 2008.

¹¹ Po aty.

¹² Po aty.

Kjo qeveri ka proceduar në Kuvend draft-ligjin mbi ‘Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurive të Zyrtarëve të Lartë Publik’ ndërsa legjislatura e kaluar ka aprovuar ‘Ligjin mbi Parandalimin e Konfliktit të Interesit gjatë Ushtrimit të Funksionit Publik’¹³. Me aprovimin e këtyre dy ligjeve, ligji bazë kundër korrupsionit praktikisht do të bëhet i paefektshëm pasi që këto dy ligje janë të përfshira si dy prej shtyllave kryesore në Ligjin kundër Korrupsionit dhe si pasojë e kësaj do të lind nevoja për krijimin e një ligji të ri kundër korrupsionit.

Në parim aprovimi i këtyre dy ligjeve për sa i përket qartësimit dhe kodifikimit ligjorë të këtyre çështjeve është shumë i domosdoshëm për realitetin kosovarë. Mirëpo, procedimi i këtyre dy ligjeve shtesë që kanë për qëllim parandalimin dhe luftimin e korrupsionit pa një ligj bazë adekuat dhe të qartë, e bën përpjekjen për luftimin kundër korrupsionit të paefektshëm në praktikë. Kjo paefektshmëri rezulton për shkak të interpretimeve të ndryshme që i bëhen ligjit bazë nga vet Agjensioni Kosovarë kundër Korrupsionit, dispozitave të tij të mangëta karshi parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe mos sistematizimit dhe harmonizimit të ligjeve tjera me ligjin bazë¹⁴. Kuadri ligjor është shumë më i gjerë dhe duhet të përfshij një harmonizim të një numri ligjesh që janë direkt të lidhura me luftën kundër korrupsionit¹⁵. Pa një sistematizim dhe harmonizim të kuadrit ligjor për sa i përket kodifikimit ligjor të një fushe të caktuar shoqërore, ndërmarrja për parandalim dhe luftim të korrupsionit nuk mund të japë rezultate efektive në praktikë.

Për më shumë, aprovimi i legjislacionit shtesë pa politika paraprake të përcaktuara në një Strategji dhe Plan Veprimi kundër Korrupsionit mbi bazë e të cilave ligjet do të krijoheshin dhe implementoheshin i shndërron ligjet e aprovuara në ‘letra të vdekura’.

Përveç kësaj, qeveria ka vendosur për krijimin e një grupi ndërministror kundër korrupsionit. Në parim, kjo iniciativë është e duhur për shkak se pa një përkrahje të qartë nga ana e qeverisë, Agjensioni Kosovarë kundër Korrupsionit nuk mund i vetëm ta parandaloj dhe luftoj korrupsionin. Mirëpo, krijimi i këtij grupi pa një udhërrëfyes të përcaktuar në një Strategji dhe Plan Veprimi kundër Korrupsionit i cili do të përcaktonte qartazi detyrat që secili institucion duhet të ndërmarr për sa i përket parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, po ashtu është i prefekt. Në këtë kontekst, krijimi i infrastrukturës shtesë ligjore dhe institucionale pa politika paraprakisht të përcaktuara dhe detajuara qartazi mund vetëm të lë përshtypje kinse po krijohet infrastruktura e domosdoshme kundër korrupsionit. Mirëpo, kjo shpie vetëm në shumëfishimin e ligjeve dhe të institucioneve kundër korrupsionit kurse në realitet përpjekja për parandalim dhe luftim të korrupsionit kufizohet vetëm në deklarata boshe pa efekte substanciale në praktikë.

Në këtë vijë, ÇOHU! rekomandon që së pari të krijohet një skemë standarde për hulumtimin e shtrirjes, formën e shfaqjes si dhe nivelin qendëror/lokal të korrupsionit.

¹³ Edhe ky Ligj ka ardhur si pjesë e objektivave të implementimit të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian.

<http://www.unmikonline.org/eu/epap.html>

¹⁴ Shih “Monitorimi i Përgjigjeve Ligjore në Rastet e Korrupsionit” – ÇOHU! – Mars 2008

¹⁵ Kurdoherë që kërkohet krijimi i një baze ligjore kundër korrupsion duhet të merren parasysh këto ligje: Ligji Anti-korrupsion, Ligji për Parandalimin të Konfliktit të Interesit, Ligji për Deklarimin e Pasurisë së Zyrtarëve Publik, Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare, Ligji për Parandalimin e Pastrimit të Parave, Ligji kundër Krimit të Organizuar, Ligji për Menaxhimin e Financave Publike, Ligji për Prokurim Publik, Ligji për Financimin e Partive Politike.

Më pastaj të krijohet një Strategji dhe Plan Veprimi kundër Korrupsionit ku do të përcaktoheshin qartazi dhe në mënyrë të detajuar detyrat që secili institucion duhet të ndërmarrë, e vetëm më pastaj të aprovohen ligjet e nevojshme kundër korrupsionit në paketë. Në të kundërtën, përpjekjet kundër korrupsionit do të përfundojnë në një rreth vicioz pa një efekt substancial në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.